# se i Dërguari i Allahut  është pyetur për gjërat që më së shumti i fusin njerëzit në Xhenet, e në atë rast ka thënë: "Më së shumti në Xhenet fut devotshmëria ndaj Allahut dhe sjellja e mirë

Ebu Hurerja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut  është pyetur për gjërat që më së shumti i fusin njerëzit në Xhenet, e në atë rast ka thënë: "Më së shumti në Xhenet fut devotshmëria ndaj Allahut dhe sjellja e mirë." Gjithashtu është pyetur për gjërat që më së shumti i fusin njerëzit në Zjarr, e në atë rast ka thënë: "Goja dhe organi gjenital."

[Hasen-sahih] [Transmetojnë Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe Ahmedi]

Profeti  në këtë hadith sqaroi se dy janë shkaqet më të mëdha që e fusin (besimtarin) në Xhenet, të cilat janë: Devotshmëria ndaj Allahut dhe sjellja e mirë. Devotshmëria ndaj Allahut (takvallëku) nënkupton që ndërmjet teje dhe dënimit të Allahut të vendosësh mburojë, gjë që arrihet duke i kryer urdhrat dhe duke iu shmangur ndalesave. Sjellja e mirë nënkupton që (besimtari) të jetë i buzëqeshur, të bëjë mirë dhe ta largojë pengesën (nga të tjerët). Dy shkaqe janë kryesoret që fusin në Zjarr, të cilat janë: Gjuha dhe organi gjenital. Prej mëkateve që i bën gjuha, janë: gënjeshtra, përgojimi, bartja e fjalëve e të tjera. Prej mëkateve që i bën organi gjenital janë: kurvëria, homoseksualizmi e të tjera.



النجاة الخيرية
ALNAJAT CHARITY
لجنة الدعوة الإلكترونية
EDC E-Da'wah Committee